



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**ZL Anr. 768/2017**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Sofije Gucati kandidate për kuvendin komunal në Skenderaj nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Skenderaj, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

## **V E N D I M**

**Refuzohet** si i pabazuar apeli i parashtruar nga Sofije Gucati kandidate për kuvendin komunal në Skenderaj nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Skenderaj, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpallje së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datën 09.11.2017 në ora 16:05, ka pranuar një apel nga Sofije Gucati kandidate për kuvendin komunal në Skenderaj nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Skenderaj në të cilën pretendon se në vendvotimet 2128B, 2130B/01R, 2130B/02D, 2121B/01R dhe 2121B/02D i mungojnë votat dhe kërkon që të rinumërohen votat për këto vendvotime.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të provave, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara pasi që parashtruesi i apelit nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me pretendimet e tij.

Parashtrimet në apel nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në vendvotimet e sipërcituara dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor për ankuesin .

Paneli vlerësoi se pretendimet në apel nuk janë të bazuara dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 10.7 pika c) të Rregullës së PZAP-it 02/2015 si dhe të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Paneli, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete lidhur me pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pa argumentuar me fakte dhe si i tillë është i pabazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
ZL Anr.768/2017 më datën 12.11.2017.



***Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.*